



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1123/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milazim Lubovci nga subjekti politik Iniciativa Qytetare e Lipjanit Demokratik (IQLD) dega në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Milazim Lubovci nga subjekti politik Iniciativa Qytetare e Lipjanit Demokratik (IQLD) dega në Lipjan .

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:03 nga parashtruesi i ankesës Milazim Lubovci ku pretendohet se, lidhur me rezultatin e shpallur nga KQZ-ja të datës 02.12.2013 në ora 17:00 nuk është i sakt, pasi që publikimi i rezultatit preliminarë i datës 04.11.2013, i njëjti i publikuar edhe në portalin zyrtar të KQZ-së nga subjekti politik IQLD kishte 418 vota duke mos i llogaritur disa VV që mungonin të dhënat. Më tutje ka shtuar se, ky rezultat nuk përputhet me rezultatin e fundit ku figuron IQLD-ja vetëm me 386 vota, prandaj bazuar në të dhënat e shpallura IQLD-ja nuk ka mundur të ketë rënje të rezultatit të votave, por në VV e datës 04.11.2013 nuk kishte të dhëna. Për më tepër ka shtuar se, sipas rezultateve të shpallura nuk ka përputhje të votave në QV 1302 sepse në rezultatin preliminarë IQLD-ja i ka 78 vota, kurse në rezultatin e fundit i figurojnë 34 vota, prandaj kërkoj që të bëhet verifikimi i sakt i votave. Pra edhe në QV 1306 figurojnë 18 vota ndërsa, në rezultatin e fundit janë 11 vota, gjë që nënkupton humbje të votave nga këto dy VV . Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka paraqitur të dhënat zyrtare të rezultateve të KQZ-së, në VV e lartpërmendura.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga Milazim Lubovci pretendohet se në, Qendrat e Votimit QV 1302, 1306 me rastin e numërimit të votave ka ndodhur humbja e votave, si

pasojë e kësaj kamë humbur një ulse në Kuvendin Komunal, mirëpo një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1123/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.